



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

01- Nr - 020/04 - 17605 dt. 03.06. 2020

Në vështrim të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për vlerësimin dhe verifikimin e gjendjes faktike nga bazenat e Feronikelit deri të bazeni i pompave në Çikatovë të Vjetër, si verifikimin e komplet rrjetit të ujësjellësit në Kamenicë, i plotësuar

- I.** Anëtarët e komisionit për vlerësimin dhe verifikimin e gjendjes faktike nga bazenat e Feronikelit deri të bazeni i pompave në Çikatovë të Vjetër dhe komplet rrjetit të ujësjellësit në Kamenicë janë:
1. Shqipdon Zariqi , (kryetar),
 2. Lavdie Bajraktari, (anëtarë),
 3. Halime Bardhi, (anëtarë).
- II.** Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin dhe verifikimin e gjendjes faktike prej bazenave të Feronikelit deri të bazeni i pompave në Çikatovë të Vjetër, si dhe komplet punimet e zhvilluara dhe ato të kontraktuara në rrjetin e Ujesjellesit në Kamenicë, pra a janë realizuar punimet e kontraktuara, me qëllim të furnizimit me ujë të pijes për banoret e fshatrave përreth.
- III.** Ky komisioni punën e tyre duhet ta kryejnë me profesionalizëm të lart dhe përkushtim.

- IV. Komisionit ka për obligim që në një afat të arsyeshëm të bëjë vlerësimin dhe verifikimin e gjendjes faktike, duke specifikuar në veçanti se sa i janë përmbajtur obligimeve kontraktuale, duke përfshi edhe përpilimin e paramasave dhe parallogarive, se a janë në përputhje me standardet e kërkuara (duke përfshi hartuesit e paramases, menaxherin e kontratave si dhe organet mbikëqyrëse, komisionet për pranimet teknike, shumat e pagesave për ujësjellësin e Kamenicës, kompanitë e kontraktuara, për secilën fazë), pra deri në cilën fazë ka arritur realizimi i këtyre projekteve, duke dhënë edhe rekomandimet e nevojshme, pastaj me anë të një raporti të njoftoj Zyrën e Kryetarit, respektivisht Kryetarin e Komunës, si dhe Drejtorinë për Infrastrukturë Lokale.
- V. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi Nr. 01-020/04-15910, i datës 14.05.2020.
- VI. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Anëtareve të Komisionit;
- DIL-së;
- Arkivit të komunës së Drenasit.